



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC -BC-2020-07
Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 10 qershor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër për Parashtrime lidhur me Riklasifikimin e Parashtrimeve të
Protokolluara**

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësve të Hysni Gucatit
Xhonatan Elistan Ris
Hju Bauden

Mbrojtësve të Nasim Haradinajt
Tobi Kadman
Karl Bakli

GJYKATËSI I PRODECURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenet 21(2) dhe 39(6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 shtator 2020, ZPS-ja parashtrori kërkesë për lëshimin e arrestimeve dhe urdhrave përkatës për transferim kundër Hysni Gucatit (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”).²

2. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi fletarrestimet kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj,³ së bashku me urdhrat për transferim të tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë (“objekti i paraburgimit të DHS-së”).⁴

¹ KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik. Përpara këtij vendimi Kryetarja kishte caktuar të njëjtin gjykatës si Gjykatës të Vetëm, shih KSC-BC-2020-07, F00003, *Kryetarja, Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas Nenit 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik.

² KSC-BC-2020-07, F00009, Prokurori i Specializuar, *Version i Redaktuar Publik i ‘Kërkesës Urgjente për Fletarrestime dhe për Urdhra në lidhje me To’ Parashtrimi i protokolluar KSC-BC-2020-07-F0009 i datës 22 shtator 2020*, 1 tetor 2020, publik, para. 35, me Shtojcat 1-2, publike.

³ KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Hysni Gucatin*, 24 shtator 2020, publik; F00012/A03/COR/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Nasim Haradinajn*, 24 shtator 2020, publik.

⁴ KSC-BC-2020-07, F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik; F00012/A04/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik.

3. Më 25 shtator 2020, z. Gucati dhe z. Haradinaj u arrestuan në Kosovë.⁵ Z. Gucati u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së më të njëjtën ditë.⁶ Z. Haradinaj u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së më 26 shtator 2020.⁷
4. Më 29 shtator 2020 dhe 1 tetor 2020, përkatësisht z. Haradinaj dhe z. Gucati, bënë paraqitjet e tyre të para.⁸
5. Më 9 qershor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake njoftoi Palët se kalimi i dosjes së çështjes Trupit Gjykues pritet të bëhet më 2 korrik 2021.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në bazë të neneve 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, seancat janë publike, përveçse kur gjykatësi kompetent vendos ndryshe në përputhje me Rregulloren.
7. Sipas rregullës 82(5) të Rregullores, në qoftë se arsyet për riklasifikim pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të parë i paraqet kërkesë panelit për riklasifikim. Një panel, mund të ndryshojë statusin e një parashtrimi të protokolluar, me kërkesë të një pjesëmarrësi apo *proprio motu*.

⁵ KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik; F00016, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik.

⁶ KSC-BC-2020-07, F00018, Administratorja, *Njoftim i Pranimi të Hysni Gucati në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, publik, me shtojcën, konfidenciale.

⁷ KSC-BC-2020-07, F00020, Administratorja, *Njoftim i Pranimi të Nasim Haradinajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020, publik, me shtojcën, konfidenciale.

⁸ KSC-BC-2020-07, F00023, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Nasim Haradinajt*, 28 shtator 2020, publik; F00029, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim për Caktimin e Datës së Paraqitjes së Parë të Hysni Gucati*, 29 shtator 2020, publik.

⁹ KSC-BC-2020-07, F00224, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Kalendari i Rishikuar për Pjesën e Mbetur të Procedurës Paraprake dhe Urdhri për Caktimin e Datës për Mbajtjen e Konferencës së Gjashtë mbi Ecurinë e Çështjes*, 9 qershor 2021, publik.

III. DISKUTIM

8. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konsideron se është e nevojshme të rishikohet riklasifikimi i disa parashtrimeve të protokolluara në dosjen e çështjes, në mënyrë që të respektohet parimi i procesit publik i cili vlen jo vetëm për seancat në sallën e gjyqit por edhe për parashtrimet e protokolluara si dhe për çdo material tjetër në dosjen e çështjes.

9. Në këtë kontekst, vëmendje duhet t'i kushtohet, nga njëra anë, parimit të gjykimit publik, siç përcaktohet në nenet 21(2) dhe 39(6) të Ligjit, dhe në anën tjetër detyrës së Gjykatësit të Procedurës Paraprake për të siguruar mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, përfshirë sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë, siç përcaktohet në nenin 23(1) të Ligjit.

10. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka përgjegjësinë të sigurojë se çdo parashtrim i protokolluar në dosjen e çështjes të ketë klasifikimin e duhur dhe, në përputhje me këtë, mund të riklasifikojë – *proprio motu* ose në bazë të një kërkesë – çdo parashtrim të protokolluar nëse arsyet për klasifikimin aktual nuk ekzistojnë më.

11. Duke marrë parasysh faktorët e lartpërmendur, në këtë fazë është e përshtatshme, që Prokurorit të Specializuar t'i kërkohet të parashtrojë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të protokolluara konfidenciale në vijim ose të tregojë nëse mund të riklasifikohen si publike, ose nëse klasifikimi aktual i tyre duhet të ruhet:

- F00180, 9 prill 2021;
- F00180/A01, 9 prill 2021;
- F00197, 11 maj 2021;
- F00202, 18 maj 2021;
- F00209/A01, 26 maj 2021;

- F00215, 3 maj 2021;
- F00218, 4 maj 2021; dhe
- F00223, 8 maj 2021.

12. Në rast se Prokurori i Specializuar dëshiron të ruajë klasifikimin aktual për disa apo për të gjitha parashtrimet e protokolluara të lartpërmendura, ai duhet të specifikojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual, në përputhje me rregullën 82(3) të Rregullores, si edhe nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimit përkatës.

13. Në këtë fazë, gjithashtu është e përshtatshme, që Mbrojtjes së z. Gucati dhe Mbrojtjes së z. Haradinaj sipas rastit, t'i kërkohet të parashtrojë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të protokolluara në vijim dhe të tregojë nëse mund të riklasifikohen si publike, ose nëse klasifikimi aktual i tyre duhet të ruhet:

- F00186, 21 prill 2021;
- F00198, 11 maj 2021;
- F00199, 11 maj 2021;
- F00200, 11 maj 2021;
- F00211, 26 maj 2021, përfshirë shtojcën;
- F00216, 3 qershor 2021;
- F00217, 3 qershor 2021;
- F00219, 4 qershor 2021; dhe
- F00220, 7 qershor 2021.

14. Në rast se Mbrojtja e z. Gucati ose Mbrojtja e z. Haradinaj dëshiron të ruajë klasifikimi e parashtrimeve të lartpërmendura, mbrojtësi duhet të specifikojë arsyet

për ruajtjen e klasifikimi aktual, në përputhje me rregullën 82(3) të Rregullores, si dhe nëse dhe kur mund të ndryshohet statusi i parashtrimit përkatës.

IV. VENDIM

15. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a. **KËRKON** nga Prokurori i Specializuar që deri më **21 qershor 2021**, të parashtrojë versionet e redaktuara publike, të kërkojë riklasifikimin si publik, ose të parashtrojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual të dokumenteve të përmendura në paragrafin 11 sipër; dhe
- b. **KËRKON** nga Mbrojtja e z. Gucati dhe Mbrojtja e z. Haradinaj, sipas rastit, që deri më 25 qershor 2021, të parashtrojë versionet e redaktuara publike, të kërkojë riklasifikimin si publik, ose të parashtrojë arsyet për ruajtjen e klasifikimit aktual të dokumenteve të përmendura në paragrafin 13, sipër.

_____/nënshkrim/_____

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E enjte, 10 qershor 2021

Në Hagë, Holandë.